Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A
Lokalno Javno Preduzeće "Kastrioti" A.D.
Local Public Enterprise "Kastrioti" J.S.C.
Obiliq
Data: 30.04.26
Nr. Prot: I-780/26

NPL

Kastrioti Sh.A
Obiliq

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

Raporti i auditorit të pavarur dhe pasqyrat financiare individuale

për vitin që përfundoi më 31 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA **FAQE**

RAPORTI I AUDITORIT	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	6
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	8
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	9
SHËNIMET E PASQYRAVE FINACIARE	10-23

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

Adresa: Rr.Llapi, p.n

Qyteti: Obiliq

NUI: 811838509

DEKLARATA E PAJTUESHMËRISË

Sipas njohurive tona, ky raport nuk përmban deklarime materiale të pasakta dhe nuk ka lëshime materiale të cilat kanë për qëllim orientimin e gabuar të shfrytëzuesëve të raportit.

Sipas njohurive tona, pasqyrat financiare dhe dokumentet tjera të prezantuara në këtë raport prezantojnë në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale pozitën financiare, rezultatet e operimit dhe rrjedhën e parasë për periudhën e prezentuar në raport.

Ne jemi përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025, në përputhje me politikat kontabël të aprovuara nga menaxhmenti/bordi i kompanisë.

Kjo përgjegjësi përfshinë: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit të brendshëm, në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare pa gabime materiale, qoftë nga mashtrimet apo pasaktësitë, përzgjedhja dhe aplikimi i politikave të duhura kontabël dhe bërja e vlerësimeve kontabël që janë të përshtatshme me natyrën e operimit të kompanisë.

Në baza të rregullta ne bëjmë vlerësimin e këtyre politikave për ta përcaktuar nevojën që kontrollet të shtohen apo të bëhet revidim i kontrollave të brendshme të atilla që sigurojnë mbrojtjen e pasurisë së kompanisë.

Flakron Mjekiqi

Ushtrues detyre

Arbnora Zeqiri

Menaxhere e Financave

prill, 2026

AUDIT & CONSULTING ASSOCIATES

Rr.Bekim Fehmiu
Icon Tower, Kati 11, Nr.110
Prishtinë
T: +383 48 211 687
E: info@acaauditing.com
W: acaauditing.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar menaxhmentit të NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare shoqëruese të NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A, të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2025, pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin që ka përfunduar në atë datë, si dhe një përmbledhje të politikave të kontabilitetit dhe shënimeve tjera shpjeguese.
Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A me 31 dhjetor 2025 dhe të përformancës financiare dhe rrjedhës së parasë së gatshme për vitin financiar që ka përfunduar në atë datë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Kompania në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA) dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave që janë të ngarkuar me qeverisjen e pasqyrave financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit.
Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimin e parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë Kompaninë, ndërpres operimin, apo nuk ka ndonjë alternativë tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë.
Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Kompanisë.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe për të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë.

Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet tjera dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rreziqe. Ne marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezulton nga mashtrimi është më i lartë se i atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime apo shkelje të kontrolleve të brendshme.
- Përfitojmë njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditim me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të Kompanisë.
- E vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruara të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushtet që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e kompanisë për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që kompania të pushojë së vazhduari në vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dh përmbajtjen e pasqyrës financiare, përfshirë shpalosje nëse pasqyra financiare përfaqëson transaksionet dhe ngjarjet përkatëse në mënyrë që të arrijë paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisje lidhur me qasjen e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.



Armend Osaj – Auditor Ligjor
ACA – Audit & Consulting Associates
Prishtinë, Kosovë
30 prill, 2026

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

Pasqyra e pozicionit financiar

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Shënimet	Më: 31-12-25	Më: 31-12-2024
Pasuritë			
Pasuritë qarkulluese:			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	68,022	41,132
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe te tjera	5	124,827	151,062
Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera	6	3,422	3,422
Stoqet		43,578	25,348
Gjithsej pasuritë qarkulluese		***239,849***	***220,965***
Pasuritë jo-qarkulluese:			
Prona, paisjet dhe impiantet	7	29,578	33,393
Gjithsej pasuritë jo-qarkulluese		***29,578***	***33,393***
Gjithsej pasuritë		**269,426**	**254,358**
Detyrimet dhe ekuiteti aksionar			
Detyrimet afatshkurtëra:			
Llogaritë e pagueshme dhe akrualet	8	11,975	98,701
Të pagueshmet tjera	9	150,804	49,734
Gjithsej detyrimet afatshkurtëra		***162,779***	***148,436***
Ekuiteti:			
Kapitali aksionar		10,000	10,000
Fitimi/Humbja i/e vitit		95,922	47,780
Fitimet e mbajtura		725	48,142
Gjithsej ekuiteti i aksionarëve		***106,647***	***105,922***
Gjithsej dhe detyrimet dhe ekuiteti		**269,426**	**254,358**

Pasqyrat financiare të përgaditura dhe aprovuara janë nënshkruar më 30 prill 2026 nga:

Flakron Mjekiqi	**Arbnora Zeqiri**	**Resul Kasumi**
Udhtrues detyre	**Menaxhere e Financave**	**Kontabilist i Çertifikuar**

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 19 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Shënimet	Më: 31-12-25	Më: 31-12-2024
Të hyrat nga shitja	10	625,132	676,005
Kostoja e mallrave të shitura	11	39,552	80,781
Fitimi bruto		**585,580**	**595,224**
Shpenzimet e personelit	12	578,798	483,927
Shpenzimet operative	13	9,486	9,083
Shpenzimet e përgjithshme dhe administrative	14	40,640	47,202
Zhvlerësimi dhe Amortizimi	7	7,142	1,419
Gjithsej shpenzimet		**636,066**	**541,630**
Të ardhurat tjera		51,400	7,142
Fitimi/Humbja para tatimit		**914**	**53,594**
Shpenzimet e pazbritshme tatimore		98	92
Shpenzimet e tatimit në fitimit	15	91	5,359
Fitimi/Humbja neto për vitin		**725**	**48,142**

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 19 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

Pasqyra e ndryshimeve në ekuitet

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
Gjendja më 01 Janar 2024	**10,000**	**47,780**	**57,780**
Fitimi/Humbja i/e vitit	-	48,142	48,142
Transaksionet e pronarit	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2024	**10,000**	**95,922**	**105,922**
Gjendja më 01 Janar 2025	**10,000**	**95,922**	**105,922**
Fitimi/Humbja i/e vitit	-	725	725
Transaksionet e pronarit	-	-	-
Gjendja më 31 Dhjetor 2025	**10,000**	**96,647**	**106,647**

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 19 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A

Pasqyra e rrjedhës së parasë

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2025

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në vleren EUR)

	Shënimet	Më: 31-12-25	Më: 31-12-2024
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative:			
Fitimi pas tatimit:		725	48,142
Zhvlerësimi	7	7,142	1,419
Humbja/Fitimi operative para ndryshimeve në kapitalin punues		**7,867**	**49,561**
(Rritja)/zvogelimi e stokut		(18,230)	(25,348)
(Rritja)/zvogelimi në llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera	5	26,235	(113,987)
(Rritja)/zvogelimi në parapagime	6	-	(2,576)
Rritja/(zvogelimi) në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	8	(86,727)	56,281
Rritja/(zvogelimi) në të pagueshmet tjera	9	101,070	5,081
Paraja neto nga aktivitetet operative		**30,215**	**(30,989)**
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investive:			
Blerja/shitja e prones, pajisjeve dhe impianteve	7	(3,327)	(34,812)
Paraja neto nga aktivitetet investive		**(3,327)**	**(34,812)**
Rritja/zvogëlimi neto në para dhe ekuivalentët e saj		**26,889**	**(65,801)**
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit	4	41,132	106,933
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit		**68,022**	**41,132**

Shënimet e bashkangjitura nga 1 deri në 19 janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare

1. INFORMATAT GJENERALE

NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE KASTRIOTI SH.A.është e regjistruar si shoqëri aksionare në korrik të vitit 2021, me numër biznesi 811838509 dhe me adresë në Obiliq, Rruga Vashingtoni, P.n., operon në treg tash e tri vite.

Veprimtari primare ka Aktivitete shërbimi të mirëmbajtjes dhe kujdesit të shesheve (mjedisit), ndërsa si veprimtari tjera janë aktivitetet e tjera të pastrimit të ndërtesave, objeteve industriale, aktivitetet e tjera tëpastrimit, demolimi i objekteve, përgatitja e vendpunishtes, instalime elektrike, punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit, punime suvatimi, aktivitetet shërbyese të rastit për transportin tokësor, kultivimi i bimëve të tjera njëvjeçare, kultivimi i bimë vetë tjera shumëvjeçare marrja dhe dhënia me qira (lizingu) e makinerisë dhe pajisjeve bujqësore, aktivitetet përkrahëse të objekteve të kombinuara.

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE DHE POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL

2.1.Baza e përgaditjes

2.1.1. Deklarata e pajtueshmërisë
Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) të lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit.

2.1.2. Bazat e matjes
Pasqyrat financiare për kompaninë janë përgaditur mbi bazën e kostos historike. Kostoja historike në përgjithësi bazohet në vlerën e drejtë të vlerës së dhënë në këmbim të të mirave dhe shërbimeve.

2.1.3. Valuta funskionale dhe e prezantimit
Valuta funksionale e kompanisë si dhe e prezantimit të pasqyrave financiare është Euro ("EUR"), e cila është valuta kryesore në Republikën e Kosovës që nga 1 janari 2002.

2.1.4. Perdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve
Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, kërkon që menaxhmenti të bëjë vlerësime dhe supozime që ndikojnë në shifrat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga këto vlerësime.
Vlerësimet dhe supozimet rishikohen mbi baza të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve njihen në mënyrë prospektive.

2.1.5. Parimi i vijueshmërisë
Pasqyra e pozicionit financiar dhe ajo e të ardhurave gjithëpërfshirëse, janë përgatitur mbi parimin e vijueshmërisë, që supozon se kompania do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë e saj dhe t'i mbuloj detyrimet, gjatë rrjedhës normale të biznesit.

2.2. Politika të rëndësishme kontabël

2.2.1 Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë në dorë, depozitat e mbajtura në bankë dhe investime të tjera afatshkurtra me likuiditet të lartë me maturime origjinale prej tre muajsh ose më pak.

2.2.2 Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Të arkëtueshmet tregtare
Të arkëtueshmet tregtare fillimisht njihen me vlerën e drejtë dhe më pas mbarten me kosto minus provizionet, nëse ka. Një provizion njihet kur ka dëshmi objektive që kompania nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha shumat e duhura sipas kushteve fillestare të të arkëtueshmeve. Shembuj të dëshmive objektive mund të jenë vështirësitë e mëdha financiare të klientit, probabiliteti i madh që klienti të falimentojë si dhe vonesat e vazhdueshme në pagesa.

Në fund të cdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperueshme.

Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjeherë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

2.2.3 Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera

Në llogarinë e parapagimeve dhe të arkëtueshmeve tjera përfshihen parapagimet dhe pasuritë e tjera qarkulluese. Parapagimet mbahen me kosto minus provizioni nëse ka. Një parapagim klasifikohet si afatgjatë kur mallrat ose shërbimet që lidhen me parapagimin pritet të merren pas një viti.

2.2.4 Stoqet

Stoqet regjistrohen në kontabilitet sipas kostos së tyre. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë stokun në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e stoqeve llogaritet duke perdorur metodën Kosto Mesatare.
Gjendjet e stoqeve janë të vlerësuara në pasqyrën e pozicionit financiar me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis kostos dhe vlerës neto të realizueshme.

2.2.5 Prona, pajisjet dhe impiantet

Prona, pajisjet dhe impiantet janë matur me kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar dhe çdo humbje e akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë).
Zhvlerësimi ngarkohet në mënyre që të ndahet kosto e pasurive minus vlera e tyre e mbetur përgjatë jetës së përdorimit të parashikuar, duke përdorur metodën lineare. Normat vjetore të mëposhtme janë përdorur për zhvlerësimin e pronës, impiantëve dhe pajisjeve:

Ndërtesat dhe struktura ndërtimore	5 %
Impiantet dhe makineria e rëndë	10 %
Pajisjet, mobilieritë, kompjuterët	20 %

Nëse ka një tregues se ka pasur një ndryshim të rëndësishëm në normën e zhvlerësimit, jetën e dobishme ose vlerën e mbetur të një pasurie, zhvlerësimi i kësaj pasurie rishikohet në mënyrë prospektive për të pasqyruar pritshmëritë e reja.

2.2.6 Dëmtimi (rënia në vlerë) i pasurive

Në çdo datë të raportimit, prona, pajisjet dhe impiantet, pasuritë e tjera të paprekshme dhe investimet në pjesëmarrje rishikohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë tregues se këto pasuri kanë pësuar ndonjë dëmtim, përkatësisht ndonjë humbje nga rënia në vlerë. Nese ka një tregues për rënie të mundshme, shuma e rikuperueshme e çdo pasurie të prekur (ose grup pasurish të ngjashme) vlerësohet dhe krahasohet me vlerën e saj kontabël. Në qoftë se shuma e vlerësuar e rikuperueshme është më e ulët, vlera kontabël ulet deri në shumën që vlerësohet se do të merret, ndërsa shuma e dëmtimit (humbja nga rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.
Fitimi ose humbja që paraqitet me rastin e shitjes ose nxjerrjes nga përdorimi i një pasurie përcaktohet si diferencë midis të ardhurave nga shitja dhe vlerës kontabël neto të një pasurie dhe si rrjedhojë njihet si fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse.

2.2.7 Llogaritë e pagueshme dhe akrualet

Shumat e pagueshme janë matur në kosto që është vlera e drejtë e shumës për t'u paguar në të ardhmen për mallërat dhe shërbimet që janë marrë. Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes.

2.2.8 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i kompanisë njihet me vlerë nominale.

2.2.9 Fitimet e mbajtura

Fitimet e mbajtura përbëhen nga fitimet e pashpërndara të kompanisë nga vitet paraprake si dhe fitimi aktual.

2.2.10 Njohja e te hyrave

Të hyrat maten me vlerën e drejtë të shumës së marrë ose të arkëtueshme dhe përfaqësojnë shumën e arkëtueshme për produktet e shitura apo shëbimet e ofruara në rrjedhën normale të biznesit, neto nga kthimet e klientëve, zbritjet dhe taksat e lidhura me shitjet.

Shitjet e mallit - Të hyrat nga shitjet e mallit njihen kur të gjitha kushtet e mëposhtme janë plotësuar:

- Shuma e të hyrave mund të matet me besueshmëri
- Është e mundshme që përfitimet ekonomike që kanë të bëjnë me transaksionin do të hyjnë në kompani
- Faza e përfundimit të transaksionit në datën e bilancit mund të matet me besueshmëri
- Kostot e shkaktuara ose që do të ndodhin në lidhje me transaksionin mund të maten me besueshmëri

Shitjet e shërbimeve – Këto të hyra njihen në periudhën kontabël në të cilën ofrohen shërbimet.

2.2.11 Tatimi ne fitim

Kompania i nënshtrohet ligjit NR. 06/L -105 për Tatimin në të ardhurat e Korporatave. Tatimi në fitim paraqet shumën e tatimit të pagueshëm aktual dhe tatimin e shtyrë. Tatimi i pagueshëm aktual është i bazuar në fitimin e tatueshëm të vitit.

2.2.12 Provizionet dhe detyrimet e papritura (kontingjente)

Detyrimet e papritura nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato janë shpalosur vetëm nëse mundësia e rrjedhës së burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Aseti kontingjent nuk është njohur në pasqyrat financiare por është shpalosur kur rrjedhja e përfitimeve ekonomike është e mundshme.

3 ADAPTIMI I STANDARTEVE TË RISHIKUARA DHE STANDARDEVE TË REJA

Pasqyrat financiare të Kompanisë janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

3.1 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet efektive në këtë periudhë

Më poshtë janë paraqitur ndryshimet në standardet ekzistuese të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Raportimit Financiar të cilat janë në fuqi për periudhën aktuale:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
SNK 1	Klasifikimi i obligimeve si afatshkurtër ose afatgjatë (Ndryshimet në SNK 1)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2024
SNK 16	Detyrimi i qirasë në një shitje dhe kthim me qira (Ndryshimet në SNRF 16)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2024
SNK 1	Detyrimet afatgjata me Konventa (Ndryshimet në SNK 1)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2024
SNK 7	Disclosures: Supplier Finance Arrangements – (Ndryshimet në SNK 7 dhe SNRF 7)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2024
SNK 1 dhe Deklarata e praktikës së SNRF 2	Shpalosja e politikave të kontabilitetit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNRF Deklarata e praktikës 2)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023
SNRF 17	Kontratat e sigurimit (Ndryshimet ne SNRF 17	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023
SNK 12	Tatimi i shtyrë në lidhje me pasurit dhe detyrimet që rrjedhin nga një transaksion i vetëm(Ndryshimet në SNK 12)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023
SNRF 17	Zbatimi fillestar i SNRF 17 dhe SNRF 9 – Informacion krahasues (Ndryshimet në SNRF 17)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023
SNK 8	Përkufizimi i Vlerësimeve Kontabël (Ndryshimet në SNK 8)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023
SNK 16	Prona, Impiantet dhe Pajisjet — Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2023

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

SNK 37	Kontratat e mëdha - Kostoja e Përmbushjes së Kontratës (Ndryshimet në SNK 37)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2022
SNRF 3	Referenca në Kuadrin Konceptual (Ndryshimet në SNRF 3)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2022
SNRF 16	Covid-19- Koncesionet e qirave të lidhura pas 30 Qershor 2021 (Ndryshimet në SNRF 16)	që fillojnë më apo pas 1 prill 2021
SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16	Reforma e standardit të normës së interest – Faza 2 (Ndryshimet në SNRF 9, SNK 39, SNRF 7, SNRF 4 dhe SNRF 16)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2021
SNRF 16	Covid-19- Koncesionet e qirave të lidhura (Ndryshimet në SNRF 16)	që fillojnë më apo pas 1 qershorit 2020
SNK 1 dhe SNK 8	Përkufizimi i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2020
Korniza konceptuale	Ndryshimet në referenca te Korniza konceptuale në standardet e SNRF	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2020
SNRF 3	Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2020
SNK 28	Interesat afatgjatë në pjesëmarrje dhe ndërmarrje të përbashkëta (Ndryshimet në SNK 28)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
IFRIC 23	Pasiguria mbi trajtimet e tatimit mbi të ardhurat	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 9	Karakteristikat e parapagimit me kompensim negativ (Ndryshimet në SNRF 9)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNK 19	Plani i ndryshimit, mbylljes ose zgjidhjes (Ndryshimet në SNK 19)	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 16	Qiratë	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019
SNRF 1	Përmirësimet vjetore në SNRF të ciklit 2015-2017	që fillojnë më apo pas 1 janarit 2019

3.2 Standardet, amendamentimet dhe interpretimet jo efektive në këtë periudhë

Në këto pasqyra financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme akoma nuk janë efektive:

Standardi	Përshkrimi	Data efektive
SNK 21	Mungesa e shkëmbimit – (Ndryshimet në SNK 21)	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2025
Ndryshime në SNRF 9 dhe SNRF 7	Ndryshime në klasifikimin dhe matjen e instrumenteve financiare	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2026
Ndryshime në SNRF 9 dhe SNRF 7	Kontrata që i referohen energjisë elektrike të varur nga natyra	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2026
SNRF 18	Paraqitja dhe Zbulimi në Pasqyrat Financiare	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2027
SNRF 19	Degë pa Përgjegjësi Publike: Zbulimet	që fillojnë më apo pas 1 Janar 2027

Kompania ka vendosur të mos i adaptojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Kompania parashikon që adaptimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat financiare të subjektit në periudhën e zbatimit fillestar.

4.PARAJA DHE EKUIVALENTËT E PARASË

Paraja dhe ekuivalentët e parasë	31-12-25	31-12-2024
Paraja në bankë	67,783	40,919
Paraja në arkë	239	213
Gjithsej	**68,022**	**41,132**

5. LLOGARITË E ARKËTUESHME TREGTARE DHE TE TJERA

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	31-12-25	31-12-2024
Llogaritë e arkëtueshme tregtare	124,827	151,062
Gjithsej	**124,827**	**151,062**

6. PARAPAGIMET DHE TË ARKËTUESHMET TJERA

Parapagimet dhe të arkëtueshmet tjera	31-12-25	31-12-2024
Parapagimet ndaj tatimit në fitim	3,422	3,422
Gjithsej	**3,422**	**3,422**

7. PRONA, PAISJET DHE IMPIANTET

	Paisjet	Total
Kosto		
Balanca më 31 dhjetor 2023	-	-
Shtesa	34,812	34,812
Heqjet	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2024	**34,812**	**34,812**
Shtesa	3,327	3,327
Heqjet	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2025	**38,139**	**38,139**
Zhvlerësimi		
Balanca më 31 dhjetor 2023	-	-
Zhvlerësimi për vitin	1,419	1,419
Heqjet	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2024	**1,419**	**1,419**
Zhvlerësimi për vitin	7,142	7,142
Heqjet	-	-
Balanca më 31 dhjetor 2025	**8,561**	**8,561**
Neto vlera		
Balanca më 31 dhjetor 2025	**29,578**	**29,578**
Balanca më 31 dhjetor 2024	**33,393**	**33,393**

8. LLOGARITË E PAGUESHME DHE AKRUALET

Llogaritë e pagueshme dhe akrualet	**31-12-25**	**31-12-2024**
Llogaritë e pagueshme tregtare	11,975	98,701
Gjithsej	**11,975**	**98,701**

9. TË PAGUESHMET TJERA

Të pagueshmet tjera	31-12-25	31-12-2024
TVSH e pagueshme	51,751	6,392
Detyrimi ndaj punetoreve	47,645	37,285
Detyrimi ndaj kontributeve pensionale	34,406	4,128
Detyrimi ndaj tatimit te mbajtur ne burim	16,911	1,929
Detyrimet ndaj tatimit në fitim	91	-
Gjithsej	**150,804**	**49,734**

10. TË HYRAT NGA SHITJA

Te hyrat nga shitja	31-12-25	31-12-2024
Te hyrat nga pastrimi dhe mirembajtja e objekteve	625,132	669,627
Te hyrat nga krasitja dhe mirembajtja e parqeve	-	6,378
Gjithsej	**625,132**	**676,005**

11. KOSTOJA E MALLRAVE TË SHITURA

Kosto e mallit të shitur	31-12-25	31-12-2024
Kosto e materialit shpenzues operativ	19,595	80,781
Kostoja e materialit shpenzues Elektros	12,396	-
Kostoja e materialit shpenzues per Higjien	7,560	-
Gjithsej	**39,552**	**80,781**

12. SHPENZIMET E PERSONELIT

Shpenzimet e personelit	31-12-25	31-12-2024
Pagat Bruto	551,236	460,882
Kontributet Pensionale	27,562	23,045
Gjithsej	**578,798**	**483,927**

13. SHPENZIMET OPERATIVE

Shpenzime operative	31-12-25	31-12-2024
Shpenzimet e derivateve	9,274	8,894
Shpenzimet e veturave	212	189
Gjithsej	**9,486**	**9,083**

14. SHPENZIMET E PËRGJITHSHME DHE ADMINISTRATIVE

Shpenzimet administrative	31-12-25	31-12-2024
Shpenzimet e tjera operuese	18,708	22,619
Shpenzimet e aseteve te medha	4,636	-
Shpenzimet profesionale juridike dhe financiare	3,873	8,707
Shpenzimet e reklames dhe reprezentacionit	2,452	1,658
Shpenzimet e mirembajtjes se zyres	2,000	83
Shpenzimet e zyres dhe administrates	1,696	84
Shpenzimet e internetit dhe telefon	1,598	1,107
Shpenzimet per operative	1,447	3,483
Shpenzimet e antarsimeve dhe licenca	1,440	4,230
Shpenzime per paisje te puntoreve/veshmbathje	1,393	-
Shpenzimet e provizioneve bankare	673	589
Shpenzimet e Kuzhines (Uji)	647	320
Shpenzime per paisje te sigurise	68	-
Shpenzimet komunalive	10	2,000
Shpenzime te Lëndime dhe Sëmundje të shkakuara pune	-	2,321
Gjithsej	**40,640**	**47,202**

15. SHPENZIMET E TATIMIT NË FITIMIT

Shpenzimet e tatimit ne fitim	31-12-25	31-12-2024
Fitimi para tatimit	914	53,502
Rregullimet per:		
Korrigjimet per qellime tatimore	98	92
Fitimi/Humbja pas korrigjimit	**1,012**	**53,594**
Tatimi ne fitim 10%	91	5,359
Tatimi ne fitim i paguar	-	7,935
Parapagimi / (Detyrimi) per tatim ne korporata	**91**	**(2,576)**

16. VLERA E DREJTË DHE MENAXHIMI I RISKUT

16.1 Objektivat e menaxhimit të rrezikut financiar

Aktivitetet e kompanisë e ekspozojnë atë ndaj një sërë rreziqesh financiare, duke përfshirë rrezikun e kredisë dhe rreziqet që lidhen me efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit në valutë të huaj dhe në normat e interesit. Menaxhimi i rrezikut të kompanisë përqendrohet në paparashikueshmërinë e tregjeve dhe kërkon të minimizojë efektet e mundshme negative mbi përformancën e biznesit të kompanisë. Menaxhimi i rrezikut kryhet nga menaxhimi i kompanisë bazuar në disa politika dhe procedura të shkruara të paracaktuara me shkrim që mbulojnë menaxhimin e përgjithshëm të rrezikut, si dhe fusha specifike, siç janë: rreziku i tregut i cili përfshinë rrezikun e valutës së huaj dhe rrezikun e normës së interesit, rreziku kreditor, rreziku i likuiditetit dhe rreziku i kapitalit.

16.2 Rreziku i tregut

Rreziku i valutës së huaj

Menaxhmenti i kompanisë është përgjegjës të ruajë pozicionin e duhur neto në secilën valutë në total dhe operacionet e tij monitorohen cdo ditë nga menaxhmenti i kompanisë.

Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit është rreziku që vlera e një instrumenti financiar të luhatet për shkak të ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rrezikun që maturitetet e pasurive me interes ndryshojnë nga maturimet e detyrimeve me interes që përdoren për të financuar ato pasuri.

16.3 Rreziku kreditor

Rreziku kreditor është rreziku i humbjeve financiare të kompanisë nëse klienti apo pala tjetër e një instrumenti financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale. Sasia e ekspozimit të kredisë në lidhje me këtë është paraqitur në vlerat kontabël të pasurive në pasqyrën e pozicionit financiar. Vlera kontabël e pasurisë financiare në pasqyrat financiare që nuk ndikohet nga humbjet, nëse ka, paraqet maksimumin e ekspozimit të kompanisë ndaj rrezikut kreditor.

16.4 Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që kompania do të hasë vështirësi në përmbushjen e obligimeve të lidhura me detyrimet financiare që lidhen me dhënien e mjeteve monetare ose ndonjë pasurie tjetër financiare. Rreziku i likuiditetit mund të ndodhë si rezultat i financimit të pasurive afatgjata me burime afatshkurtëra. Kompania e monitoron likuiditetin e saj në baza të vazhdueshme në mënyrë që të menaxhojë detyrimet e saj në momentin kur ato tejkalojnë afatin/kohën e shlyrjes.

(Të gjitha vlerat janë prezantuar në EUR)

	Më 31 dhjetor 2025	Më 31 dhjetor 2024
Pasuritë qarkulluese		
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	68,022	41,132
Llogaritë e arketueshme tregtare dhe të tjera	124,827	151,062
Stoqet	43,578	25,348
Parapagimet dhe kërkesat tjera	3,422	3,422
Gjithsej pasuritë qarkulluese	**239,849**	**220,965**
Detyrimet qarkulluese		
Llogaritë e pagueshme	11,975	98,701
Të pagueshmet tjera	150,804	49,734
Gjithsej detyrimet qarkulluese	**162,779**	**148,436**
Hapësira e likuiditetit	**1.47**	**1.49**

16.5 Rreziku i kapitalit

Kompania menaxhon kapitalin e saj duke siguruar se janë të aftë të vazhdojnë aktivitetin sipas hipotezës së vijimësisë për deri sa maksimizojnë kthimet për pronarin përmes optimizimit të balancës së borxhit dhe pasurive. Struktura e pasurisë së kompanisë përbëhet nga paraja, të arkëtueshmet, stoqet dhe pasuritë jo-qarkulluese. Struktura e borxhit dhe e kapitalit të kompanisë përbëhet nga borxhet, të cilat përfshijnë huatë dhe ekuiteti i atribushëm të mbajtësit të ekuitetit, që përbëhet nga kapitali dhe fitimet e mbajtura.

	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Raporti i obligimeve:		
Gjithsej detyrimet	162,779	148,436
Gjithsej pasuritë	269,426	254,358
Raporti	**0.60**	**0.58**

17. VLERA E DREJTE E INSTRUMENTEVE FINANCIARE

Menaxhmenti i kompanisë konsideron se vlera kontabël e pasurive financiare dhe detyrimeve financiare janë të regjistruara sipas kostos historike. Menaxhmenti bënë vlerësime të vazhdueshme nëse këto instrumente duhet të provizionohen ose të shlyhen.

-	31 Dhjetor 2025	31 Dhjetor 2024
Pasurite financiare		
Paraja dhe ekuivalentet e parase	68,022	41,132
Llogarite e arketueshme tregtare dhe te tjera	124,827	151,062
Gjithsej	**192,848**	**192,194**
Detyrimet financiare		
Llogarite e pagueshme tregtare dhe te tjera	11,975	98,701
Gjithsej	**11,975**	**98,701**

18 KONTIGJENCAT DHE ZOTIMET

18.1 Çështjet ligjore

Për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2025 kompania nuk ka ndonjë detyrim kontingjent që kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të saj.

18.2 Detyrimet tatimore

Librat e kompanisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2025. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme. Legjislacioni tatimor dhe doganor i Kosovës i cili është miratuar ose në thelb i miratuar në fund të periudhës raportuese, është subjekt i interpretimeve të ndryshme kur zbatohet për transaksionet dhe aktivitetet e kompanisë.


Rrjedhimisht, pozicionet tatimore të marra nga menaxhmenti dhe dokumentacioni formal që mbështet pozicionet tatimore mund të kundërshtohen nga autoritetet tatimore.

19 NGJARJET PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ngjarje domethënëse pas datës së raportimit që mund të kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare.

N.P.L
KASTRIOTI
SH.A

RAPORTI VJETOR 2025



NDËRMARRJA PUBLIKE LOKALE "KASTRIOTI" SH. A

PËRMBAJTJA

1. HYRJE 3
2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 3
3. AKTIVITETET KRYESORE 2025 3
4. PROFILI I NDËRMARRJES 3
5. QËLLIMI I RAPORTI....4
6. METODOLOGJIA 4
7. KORNIZA LIGJORE 4
8. STRUKTURA ORGANIZATIVE 5
9. RAPORTI OPERATIV 6
10. Kontratat në fuqi gjatë vitit 2025 6
11. Raporti i realizimit të kontratave dhe shërbimeve 7
11.1 Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit 7
11.2 Drejtoria e Arsimit....12
11.3 Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale 18
11.4 Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit 24
11.5 Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave 31
11.6 Drejtoria e Administratës së Përgjithshme 40
12. RAPORTI VJETOR I SEKRETARIT TË NDËRMARRJES 41
13. RAPORTI VJETOR I PUNËS SË BURIMEVE NJERËZORE 43
14. RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRTARIT LIGJOR 46
15. RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRËS PËR PROKURIM 48
16. RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN FISKAL 2025 53
17. DEKLARATË E MENAXHMENTIT 57
18. PËRFUNDIMI 58

1. HYRJE

Ky raport vjetor paraqet aktivitetet, rezultatet dhe performancën e Ndërmarrjes Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A. për vitin 2025. Përmes këtij raporti synohet të ofrohet një pasqyrë e plotë dhe transparente mbi funksionimin e ndërmarrjes, duke përfshirë aspektet operative, financiare dhe organizative.
Gjatë vitit raportues, ndërmarrja ka zhvilluar aktivitetet e saj në përputhje me obligimet ligjore dhe kontraktuale, duke u fokusuar në ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët e komunës së Obiliqit.

2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2025, NPL "Kastrioti" Sh.A. ka realizuar një sërë aktivitetesh në kuadër të kontratave të lidhura me Komunën e Obiliqit. Aktivitetet kryesore kanë përfshirë mirëmbajtjen e hapësirave publike, shërbimet komunale, mirëmbajtjen e objekteve publike dhe mbështetjen e institucioneve komunale.
Ndërmarrja ka arritur të përmbushë në masë të madhe obligimet e saj kontraktuale, duke siguruar funksionim të qëndrueshëm dhe ofrim të vazhdueshëm të shërbimeve. Megjithatë, gjatë vitit janë përballur edhe sfida që lidhen me ngarkesën operative dhe burimet financiare.

3. AKTIVITETET KRYESORE 2025

Gjatë vitit 2025, nërmarrja ka zhvilluar aktivitetet e saj kryesisht në fushën e mirëmbajtjes së hapsirave publike, ofrimit të shërbimeve komunale dhe mbështjetjes së institucioneve komunale, duke u fokusuar në shërbimeve.

4. PROFILI I NDËRMARRJES

NPL "Kastrioti" Sh.A. është ndërmarrje publike lokale që operon në territorin e komunës së Obiliqit, me qëllim ofrimin e shërbimeve publike për qytetarët.

Aktivitetet kryesore të ndërmarrjes përfshijnë:
- Mirëmbajtjen e hapësirave publike
- Shërbimet komunale
- Mirëmbajtjen e objekteve publike
- Shërbime të tjera operative në funksion të komunës.

Misioni i ndërmarrjes është ofrimi i shërbimeve cilësore dhe efikase, ndërsa vizioni është zhvillimi i qëndrueshëm dhe përmirësimi i vazhdueshëm i shërbimeve.

5. QËLLIMI I RAPORTIT

Qëllimi i këtij raporti është:

- Të paraqesë aktivitetet dhe rezultatet e ndërmarrjes gjatë vitit 2025
- Të sigurojë transparencë ndaj institucioneve dhe qytetarëve
5	Furnizimi, transporti dhe montimi i kontaktorit TIP CN 75-160 A sipas nevojës me shpull 380/220 C i vendosur në orman të grupit matës.	7	5	0	2	**14**	**copë**
6	Furnizimi, transporti dhe montimi i vazhduesve kabllovik (muf) me dim. 50, 25, dhe 16mm² (qmimi.Mesatarë)	3	0	0	1	**4**	**copë**
7	Role Kohore	5	9	1	7	**22**	**copë**
8	Makinë me platform hidraulike me shportë (korpë).	22	26	44	71	**163**	**orë**
9	Largimi i shtyllave të ndriçimit publikë nga rrugët, sheshet dhe dërgimi i tyre në depo (depo caktohet nga menaxheri I kontratës).	3	0	1		**4**	**copë**
10	Identifikimi i prishjeve në shtyllë.	40	59	72	61	**232**	**copë**
11	Demontimi i trupave ndriçues, materiali i demontuar duhet të transportohet në deponin më të afërt legale	37	0	252	531	**820**	**copë**
12	Furnizimi, transporti dhe montimi i trupit Led me këto karakteristika: Tensioni hyrës: 90-264 V AC,50-60 Hz, DC LED Q' ty& Fuqia:100W Frequency Range 50 – 60 HZ Efiçienca: min 90 lm/W Power LED Color Temperature: >4000 Material: Aluminium Qendrueshmëria min 50000 orë pune Garancioni 3 vite.	2	30	14	1	**47**	**copë**


13	Furnizimi, transporti dhe montimi i Kuadrit qendror për furnizimin e ndriçimit publik, me pjesën e gjamit shtesë nga jashtë për leximin e njehsorit, pjesën e zbrazur rezerve të mbrojtur me dim deri në 120.x90x30. në çmim pwrfshihen edhe elmentet e cekura më poshtë: Ndërprerës AS-/A 1.Transformatorë rrymorë /5 A 6. Mikrondërpresë /A 1. Portllampë E27 1. Poç fluroshent 1x18w me baze 1. Prizë OG 16 A 1. Voltmetër Vm 0-500 V 1. Ampermetër Am 0-200A 1. Ndërp. Zgjedhës për Am80A-u-R10 2.Ndërprerës tipi GS-16-66 U 1. Siguresa njëpolare automatike 10-16A schneider ose ekuivalente 6.Përçues 1x25mm 2(m) 50. Kontaktor tip CS 160 ose 100A 3.Ndërprerësi automatik/A 1. Rele IC Astro 1.	1	1	1	1	**4**	**copë**
14	Dislokimi I kabllove ekzistues nga shtyllat e drurit në shtyllat e betonit, metalit dhe anasjelltas.	0	60	0	120	**180**	**m'**
15	Furnizimi, transporti dhe montimi i Lidhëseve (klema) "Unimax", Al – Cu ose të tjerë, për vazhdimin e përçuesve në kabllo, shtylla të betonit dhe të drunjëta, me dimenz. Të ndryshëm	0	15	20	0	**35**	**copë**
16	Furnizimi, transporti dhe montimi i papuçeve, shticne, shtrëngues gëzhojave për lidhjen e kabllove në orman për 4x16mm² Al-Cu	0	4	36	101	**141**	**copë**
17	Furnizimi dhe montimi i reflektorëve LED 50w	0	1	7	0	**8**	**copë**
18	Demontimi i trupave ndriçues, materiali i demontuar duhet të transportohet në deponin më të afërt legale	0	87	0	0	**87**	**copë**
19	Furnizimi, transporti dhe montimi i Lirave një anësore (mbajtës të trupave ndriques1.50m me hark).	0	0	15	54	**69**	**copë**


20	Furnizimi dhe montimi i reflektorëve LED 100w	0	0	2	0	**2**	**copë**
21	Furnizimi, transporti dhe montimi i shtyllës së betonit 9m.	0	0	2	1	**3**	**copë**
22	Furnizimi, transporti dhe montimi i unazave rreth shtyllave për përforcimin e llauferit deri në 2x16mm.	0	0	21	29	**50**	**copë**
23	Ray Kleme 25-50 mm	0	0	25	210	**235**	**m'**

Kontratë për shërbime "Kontratën në shtëpi" me nr 03/24 të datës 29.03.2024 Ofrim I shërbimeve të recepsionit në objektet komunale - Të dhëna për shërbimet e realizuara për Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Emergjencave


Nr	Përshkrimi i pozicionit:	TM1	TM2	TM3	TM4	Total	Njësia
1	Ofrim I shërbimeve të Recepsionit në administratën komunale, qendres për punë sociale, palestres sportive, Shtëpisë së kulturës, bibliotekës dhe objekteve të tjera komunale (nga muaji Shkurt janë nda në drejtoria).	2542	1736	2080	1736	**8094**	**Orë**


Pamje nga realizimi i aktiviteteve të mirëmbajtjes së infrastrukturës publike, përfshirë ndriçimin publik, shërbimet komunale, si dhe dekorimin e qytetit gjatë festave të fundvitit.















11.6 Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Në kuadër të bashkëpunimit me Drejtorinë e Administratës së Përgjithshme, ndërmarrja ka ofruar shërbime mbështetëse gjatë vitit 2025, bazuar në kontratat në fuqi. Këto shërbime kanë përfshirë aktivitete administrative dhe operative që kanë ndihmuar në funksionimin e përditshëm të institucioneve komunale.

Kontratë për shërbime "Kontratën në shtëpi" me nr 02/24 të datës 01.03.2024 dhe aneks kontrata me nr.02-1/24 të datës 03.02.2025, për mirëmbajtjen dhe pastrimin e hapësirave publike në komunën e Obiliqit -Të dhëna për shërbimet e realizuara për Drejtorinë e Administratës

Nr.	Përshkrimi i pozicionit:	TM1	TM2	TM3	TM4	Total	Njësia
1	Miëmbajtja higjienike dhe pastrimi i objekteve në brendësi (Hapësirat e brendshme Inventari, Dyshemeja, Tualeti). Në: Objektin e administratës komunale(1895m2)	5685	5685	5685	5685	**22740**	**m^2**
2	Letër role tualeti (10/1) komplet	29	16	23	39	**107**	**copë**
3	Letër kuzhine 500 Gr.	150	163	197	198	**708**	**copë**

Pamje nga realizimi i shërbimeve mbështetëse dhe mirëmbajtjes në objektet administrative gjatë vitit 2025.





12. RAPORTI VJETOR I SEKRETARIT TË NDËRMARRJES

Me anë të Raportit Vjetor për vitin 2025, do të paraqesim të gjitha faktet reale që e kanë shoqëruar punën e Bordit të Drejtorëve prej datës 01.01.2025 deri 31.12.2025.

Ky raport shërben për të vënë në dijeni me të gjitha vendimet dhe informimet që janë ndërmarrë gjatë vitit ku synon të ofrojë transparencë institucionale, vlerësim objektiv të gjendjes dhe rekomandime për përmirësim në vitin vijues.

- **Korniza ligjore dhe institucionale**

Gjatë vitit 2025 veprimtaria e Sekretarisë për Ndërmarrjet Publike është zhvilluar në përputhje me:

12.1.1. Ligjin për Ndërmarrjet Publike,
12.1.2. Ligjin e Punës,
12.1.3. Ligjin për Shoqëritë Tregtare,
12.1.4. Statutet dhe aktet nënligjore përkatëse,
12.1.5. Vendimet e Kuvendit Komunal,
12.1.6. Rregulloret e brendshme të ndërmarrjeve publike.

Po ashtu gjatë vitit 2025 janë realizuar këto aktivitet kryesore:

Koordinimi i punës ndërmjet ndërmarrjes publike dhe organeve komunale; Monitorimi i zbatimit të planeve të punës dhe buxheteve vjetore; Inicimi dhe ndjekja e procedurave disiplinore dhe administrative sipas kërkesës; Shqyrtimi dhe plotësim ndryshimi i të gjitha rregulloreve.

Vendimet:

- Vendim me datën 01.04.2025 nga Komisioni Komunal i Aksionarëve pas vlerësimit pozitiv të përformances, raporteve 3 mujore dhe vjetore bëhet vazhdimi i mandatit për 3 anëtarët e Bordit të NPL "Kastrioti" Sh.A
- Vendim me datën 13.08.2025 nga Komisioni Komunal i Aksionarëve, emëron Albina Paloji, anëtare e përkohshëm e Bordit të Drejtorëve. Emërimi i anëtares të Bordit të Përkohshëm bëhet deri në hapjen e konkursit për Anëtarin e rregullt të Bordit të Drejtorëve , por jo më shumë se gjashtë (6) muaj
- Vendim për rritjen e pagës bazë 50 euro datë 30.06.2025;
- Vendim për aprovime dhe caktim të pagës bazë për Drejtorin Operativ datë 30.06.2025;
- Vendim për aprovim të Planin e Biznesit dhe Buxhetit datë 30.10.2025;
- Vendim për autorizim të ZKF-ës dhe KE-së për çështjen e ATK-ës datë 30.10.2025.
- Mbledhjet e Bordit nga data 27.01.2025 e deri me datën 13.01.2026 janë mbajtur gjithsej dymbëdhjetë (12) mbledhje të rregullta nga Bordi i Drejtorëve;
- Janë përgatitur raportet tre (3) mujorësh për periudhat TM1, TM2, TM3, dhe TM4;
- Pjesëmarrja aktive në mbledhje të BD, përgatitjet e procesverbaleve të këtyre mbledhjeve;

- Si dhe punimin e të gjitha vendimeve të marra nga ana e Bordit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet rregullta të zyrtareve të lartë të ndërmarrjes.

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja ka operuar në bazë të kontratave të lidhura me Komunën e Obiliqit, kryesisht përmes formës së kontratave "në shtëpi". Këto kontrata kanë përfshirë fusha të ndryshme të shërbimeve publike, duke siguruar funksionim të vazhdueshëm të aktiviteteve të ndërmarrjes.

Përshkrimi i detajuar i kontratave dhe aktiviteteve përkatëse është paraqitur në Raportin e Operativës.

Po ashtu, gjatë vitit 2025 janë realizuar edhe aktivitete të tjera administrative, përfshirë nxjerrjen e vendimeve për formimin e komisioneve të ndryshme, si dhe detyra të tjera që lidhen me funksionimin administrativ të ndërmarrjes.

13. RAPORTI VJETOR I PUNËS SË BURIMEVE NJERËZORE

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2025, Sektori i Burimeve Njerëzore ka ushtruar funksionet e tij në mënyrë të vazhdueshme dhe të strukturuar, duke mbuluar të gjitha proceset që lidhen me menaxhimin e marrëdhënieve të punës në ndërmarrje, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike, Ligjin e Punës, aktet nënligjore përkatëse, si dhe rregulloret e brendshme të ndërmarrjes.

Në këtë periudhë janë administruar dhe përditësuar kontratat e punës, duke siguruar respektimin e kushteve kontraktuale, strukturës organizative dhe sistemit të pagave të miratuar. Po ashtu, është realizuar administrimi i pagave dhe kompensimeve, përfshirë pagesat shtesë, përfitimet dhe obligimet përkatëse, në përputhje me vendimet e organeve drejtuese dhe dispozitat ligjore.

Sektori i Burimeve Njerëzore ka menaxhuar në mënyrë të rregullt pushimet vjetore, pushimet mjekësore dhe llojet e tjera të pushimeve, duke siguruar evidencë të saktë, planifikim adekuat dhe zbatim të barabartë të të drejtave të punonjësve.

Gjatë vitit raportues janë zhvilluar dhe administruar procedura rekrutimi dhe konkurse publike, në përputhje me parimet e transparencës, barazisë dhe meritokracisë, si dhe janë mbështetur proceset përkatëse të përzgjedhjes dhe emërimit të personelit.

Po ashtu, Sektori i Burimeve Njerëzore ka ofruar mbështetje administrative dhe procedurale për komisionet disiplinore, duke siguruar zbatim të rregullt të procedurave disiplinore, respektim të të drejtave të palëve dhe dokumentim të plotë të rasteve të trajtuara.

Në kuadër të përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, gjatë vitit 2025 janë hartuar dhe përditësuar përshkrimet e vendeve të punës, të cilat kanë shërbyer si bazë për qartësimin e përgjegjësive, vlerësimin e performancës dhe planifikimin e zhvillimit profesional të stafit.

13.1. Struktura Organizative dhe stafi

Gjatë vitit 2025, Ndërmarrja Publike Lokale "Kastrioti" Sh.A. ka pasur këtë përbërje të stafit:

- Numri i përgjithshëm i të punësuarve: 86
- Punonjës me kontratë me afat të pacaktuar: 47
- Punonjës me kontratë me afat të caktuar: 39

13.2. Rekrutimi dhe Punësimi

Gjatë vitit raportues janë realizuar:

- 28 procedura rekrutimi për pozita të ndryshme
- 18 punësime të reja
- 8 përfundime të marrëdhënies së punës

13.3. Menaxhimi I kontratave dhe Dosjeve Personale

Zyra e Burimeve Njerëzore ka:

- Administruar kontratat e punës
- Përditësuar dosjet personale të punonjësve
- Përgatitur vendime administrative sipas nevojës

13.4. Trajnimi dhe Zhvillimi Profesional

Gjatë vitit 2025 janë realizuar:

- 5 trajnime profesionale
- 71 punonjës të përfshirë në trajnime

Fushat kryesore të trajnimit kanë qenë:

- Vlerësimi i rrezikut dhe siguria në punë
- Procesi i rekrutimit – Burime Njerëzore
- Menaxhimi i kontratave
- Microsoft Excel
- Trajnimi hyrës për nëpunësit e rinj civil në shërbimin civil të Kosovës.

13.5. Vlerësimi i Performancës së Punonjësve

Është zbatuar procesi i vlerësimit të performancës për punonjësit e ndërmarrjes, në përputhje me aktet e brendshme.

Rezultatet e vlerësimit kanë shërbyer për:

- Identifikimin e nevojave për trajnim
- Përmirësimin e efikasitetit në punë

13.6. Marrëdhëniet e Punës dhe Disiplina

Gjatë vitit 2025:

- Janë trajtuar çështje të ndryshme të marrëdhënieve të punës
- Janë respektuar procedurat disiplinore kur ka qenë e nevojshme
- Janë hartuar dhe përditësuar rregullore të ndryshme, me qëllim rritjen e efikasitetit, shmangien e keqkuptimeve dhe harmonizimin me standardet në fuqi.

13.7. Marrëdhëniet e Punës

- Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore
- Rritja e kapaciteteve profesionale të stafit
- Digjitalizimi i dokumentacionit të personelit
- Forcimi i disiplinës dhe etikës në punë

13.8. Aktivitetet Mujore

Aktivitetet e detajuara mujore të Sektorit të Burimeve Njerëzore për vitin 2025, janë paraqitur në tabelat përkatëse në shtojcën e këtij raporti, ku janë përshkruar në mënyrë të detajuar të gjitha veprimet administrative për secilin muaj.

Nr.	Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
1	Lista e pagave	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	12
2	Vendim për pushim pa pagesë	3	3	3	2	2	4	4	4	7	4	1	1	38
3	Vendim pushim lehonisë	2	2	2	2	2	1	1			1	1	1	15
4	Pushim mjekësor	1	3	4	2	1	2	5	6	4	4	4	4	40
5	Kontratë 6 mujore	4		4	9					4				21
6	Shpallje konkursi intern	2	1			1			1			1		6
7	Shpallje konkursi publik : Punëtor fizik – Pastrues/e, Punëtor për mirëmbajtjen e mjedisit, Kuzhinier/e, Ndihmes kuzhinier/e.	1												1
8	Vendime të orëve shtesë	30	21	18	8	32	32	32	36	30	28	25	28	320
9	Konkurs në procedurë : Sigurim i objektit, Suvatues, Recepsion dhe Punëtor fizik – Pastrues/e.	4												4
10	Trajnime : Vlerësimi i rrezikut dhe siguria në punë; Procesi i rekrutimit – Burime Njerëzore; Menaxhimi i kontratave; Microsoft excel; Trajnimi hyrës për nëpunësit e ri civil në shërbimin civil të Kosovës.	5												5
11	Raport pune i komisioneve (Shpallje, Njoftime, Ankesave)	20	37	23		5	5			5	7	18	8	128
12	Kontratë në kohë te pacaktuar	1	4	1				1	4				4	15
13	Konkurse në procedurë: Punëtor fizik – Pastrues/e, Punëtor për mirëmbajtjen e mjedisit, Kuzhinier/e, Ndihmes kuzhinier/e.		4											4
14	Vendim për refuzim të aplikacioneve për kandidatet që nuk i kanë plotësuar kriteret për konkursin publik		4							2		65		71
15	Vendim për ndërprerje te pushimit vjetor		1										1	2
16	Kontratë një vjeqare		1	1	2			5	2	12		1		24
17	Ndërprerje e kontrates			1	2	1	1			1		1	2	9
18	Vendim për Ndërrim i pozitës			2				2	2	1		1		8
19	Vendim për pushim vjetorë	14	8	11	14	17	27	19	24	15	5	7	12	173
20	Vendim për refuzim të pushimit vjetorë				2									2
21	Komision disiplinor					1								1
22	Vendim për anulim të pushimit vjetor							1					1	2
23	Shpallje konkurs publik për pozitat: Punëtor fizik-Pastrues/e, Punëtorë për mirëmbajtjen e mjedisit, Punëtor fizik-Recepsion, Shofer kategoria "B", Shofer kategoria "C", Elektricist, Kuzhinier/e, Ndihmës kuzhinier/e,Punëtor IT.									9				9
24	Aplikim prej platformes Super Puna pozita:Pastrues/e									2				2
25	Kontratë tre vjeqare Sekretar i Përgjithshëm i NPL									1				1
26	Njoftim për shtyrje të afatit për verifikim të aplikacioneve për konkursin publik										1			1
27	Procesverbal i verifikimit të aplikacioneve për konkursin publik										2	1		3
28	Procesverbal i verifikimit të aplikacioneve për konkursin publik											1		1

14. RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRTARIT LIGJOR

14.1. Hyrje

Zyra Ligjore – në kuadër të NPL "Kastrioti" Sh.A, gjatë vitit 2025 ka vazhduar me angazhime të rregullta dhe profesionale në përputhje me kompetencat që rrjedhin nga dispozitat ligjore në fuqi.

Gjatë kësaj periudhe është punuar në përgatitjen dhe harmonizimin e akteve nënligjore me legjislacionin përkatës, si dhe janë ofruar interpretime ligjore për departamentet e ndryshme të ndërmarrjes, duke kontribuar në funksionimin e ligjshëm dhe efikas të saj.

14.2. AKTIVITETET KRYESORE GJATË VITIT 2025

Në cilësinë e zyrtarit ligjor, aktivitetet kryesore kanë përfshirë:

- Hartimin dhe përditësimin e akteve nënligjore të ndërmarrjes
- Dhënien e këshillave dhe interpretimeve ligjore për stafin administrativ
- Pjesëmarrjen në komisione të ndryshme, përfshirë:
  - Vlerësimin e ofertave në procedura të prokurimit
  - Vlerësimin e kandidatëve për konkurse publike

- Përgatitjen e vendimeve administrative, përfshirë:
  - Emërimin e menaxherëve të kontratave
  - Emërimin e komisioneve punuese
  - Caktimin e personave për hartimin e specifikave teknike

- Bashkëpunimin me Njësinë e Burimeve Njerëzore në:
  - Hartimin e kontratave të punës
  - Vendimet për vazhdim të marrëdhënies së punës

- Menaxhimin e kontratave, përfshirë kontratën për furnizim me lule sezonale
- Përfaqësimin e ndërmarrjes në takime në PAMKOS, si pjesë e këshillit konsultativ juridik
- Zhvillimin e procedurave disiplinore në cilësinë e Kryetarit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë
- Përgatitjen e procesverbaleve të mbledhjeve të menaxhmentit

14.3. Raport përmbledhës i aktiviteteve

Lloji I aktivitetit	Numri i realiimeve
Vendime për pushim pa pagesë	8
Procesverbale të mbledhjeve të menaxhmentit	11
Vendime për emërimin e menaxherit të kontratës.	26
Kontrata pune me afat të pacaktuar	7
Kontrata pune me afat të caktuar	31
Vendime për vazhdimin e kontratave me afat të pacaktuar	7
Vendime për vazhdimin e kontratave me afat të caktuar	31
Vendime për emërimin e komisioneve punuese	30
Vendime për vazhdimin e pushimit të lehonisë	2
Vendime për ndërprerjen e pushimit të lehonisë	2
Vendime për fillimin e pushimit të lehonisë	1
Raporte mujore të punës së administratës	12
Vendime për ushtrues detyre	3
Vendime për refuzimin e aplikacioneve për punësim	5
Vendime për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me kërkesë të palës	3
Autorizime për përfaqësim në institucione publike	1
Vendime për caktimin e personave për hartimin e specifikave teknike	26
Vendime për emërimin e komisionit disiplinor (shkalla e parë)	1
Vendime për emërimin e komisionit disiplinor (shkalla e dytë)	1
Vendime të formës së prerë të komisionit disiplinor	1
Vendime për sistemim të përkohshëm të punëtorëve	10

15. RAPORTI VJETOR I PUNËS SË ZYRËS PËR PROKURIM

Aktivitetet e prokurimit për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, Zyra e Prokurimit ka zhvilluar gjithsej 42 procedura të prokurimit, të iniciuara bazuar në kërkesat e njësive kërkuese të ndërmarrjes. Të gjitha kërkesat e pranuara janë trajtuar në përputhje me procedurat ligjore dhe asnjë kërkesë nuk ka mbetur e pa procesuar.

Nga këto procedura, janë nënshkruar 30 kontrata për furnizime dhe shërbime, ndërsa një numër i procedurave vazhdojnë në realizim dhe pritet të përfundojnë gjatë vitit pasues, në përputhje me afatet ligjore.

Gjatë kësaj periudhe, 8 procedura janë anuluar, për shkak të mosplotësimit të kritereve nga operatorët ekonomikë ose mungesës së ofertave të përgjegjshme.

Po ashtu, një pjesë e furnizimeve është realizuar përmes kontratave të centralizuara nga AQP, të cilat përfshijnë furnizime të ndryshme për nevoja operative të ndërmarrjes.

Vlera totale e kontratave të realizuara gjatë vitit 2025 arrin në 237,183.44 €.

Nr	Titulli I aktivitetit të prokurimit	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Emri i OE	Çmimi I kontrates	Data e përfundimit	Statusi
1	NPL KASTRIOTI - 25-161-1-3-6	Furnizim me material elektrik për objektet shkollore në Komunën e Obiliqit	" INFINITT " SH.P.K.	1,377.90 €	10.02.2025	Përfunduar
2	NPL KASTRIOTI - 25-1276-2-4-7	Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2024	ACA Audit & Consulting Associates SH.P.K.	950.00 €	04.04.2025	Përfunduar
3	NPL KASTRIOTI - 25-1294-2-4-7	Përgaditja,Nënshkrimi dhe çertifikimi i pasqyrave Financiare për vitin 2024	Accounting Center Kosumi L.L.C.	950.00 €	06.04.2025	Përfunduar

4	NPL KASTRIOTI - 25-1386-1-4-7	Furnizim me material shpenzues për makinerin TIMAN 3330	" Profitech " SH.P.K.	989.90 €	06.04.02 5	Përfunduar
5	NPL KASTRIOTI - 25-1870-1-4-7	RITENDER- Furnizim me material esencial për higjienë për nevoja të NPL Kastrioti Sh.A	" NEXHI - PAKO " SH.P.K.	889.15 €	15.04.20 25	Përfunduar
6	NPL KASTRIOTI - 25-2210-1-4-7	Organizimi i i iftarit për të gjithë stafin e NPL Kastrioti Sh.A me rastin e muajit të shenjët të Ramazanit	" BLENDI " SH.P.K.	994.50 €	27.03.20 25	Përfunduar
7	NPL KASTRIOTI - 25-1669-2-2-1	Marrja me qera e makinerive për nevoja të NPL Kastrioti SH.A	" AR- AM- ING " SH.P.K.	20,000.00 €	18.04.20 25	Përfunduar
8	NPL KASTRIOTI - 25-3398-1-4-7	Furnizim me lule sezonale- Ritenderim-I-	N.T.P. LULISHTJA BUÇAJ	980.00 €	23.05.20 25	Përfunduar
9	NPL KASTRIOTI - 25-3871-1-4-7	Furnizim me material higjienik per nevoja të NPL Kastrioti Sh.A	" M & A " SH.P.K	989.80 €	06.06.20 25	Përfunduar
10	NPL KASTRIOTI - 25-3880-1-4-7	Furnizim material elektrik per objektet kulturore ne komunen e Obiliqit	" INFINITT " SH.P.K.	997.00 €	06.06.20 25	Përfunduar
11	NPL KASTRIOTI - 25-4029-1-4-7	Furnizim me lëndë druri dhe paisje për rregullimin dhe meremetimin e objekteve komunale	" AR- AM- ING " SH.P.K.	990.40 €	12.06.20 25	Përfunduar

12	NPL KASTRIOTI - 25-2524-1-2-1	Furnizim me material të nevojshëm për nevoja të operativës	Liria SH.P.K.	90,000.00 €	22.05.2027	Në proces
13	NPL KASTRIOTI - 25-5238-1-4-7	Furnizim me shtylla betoni, rrjetë të galvanizuar për nevoja të NPL Kastrioti Sh.A	Smartech Systems L.L.C.	989.00 €	11.07.2025	Përfunduar
14	NPL KASTRIOTI - 25-3723-1-2-1	Furnizim me inventar për zyre dhe depo	" INFINITT " SH.P.K.	14,000.00 €	19.06.2027	Në proces
15	NPL KASTRIOTI - 25-4496-1-3-6	Furnizim me drita dhe paisjeve përcjllëse për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në tërë teritorin e Komunës së Obiliqit sipas kontratës 04 24	" Item EL " SH.P.K.	7,333.00 €	26.12.2025	Përfunduar
16	NPL KASTRIOTI - 25-1331-1-2-1	RITENDER-Furnizim me material higjienik për nevoja të NPL Kastrioti Sh.a	Shaip Mustafa B.I.	19,800.00 €	09.07.2025	Ne proces
17	NPL KASTRIOTI - 25-6220-1-4-7	Furnizim me uniforma per punetoret e operatives te Npl Kastrioti Sh.A-Ritender	" Sankos " Sh.p.k.	982.60 €	30.07.2025	Përfunduar
18	NPL KASTRIOTI - 25-6389-1-4-7	Furnizim me pije dhe ushqim për shënimin e përvjetorit të NPL Kastrioti Sh.A-Ritender	Fatmir Mjeku B.I.	989.80 €	15.08.2025	Përfunduar
19	NPL KASTRIOTI - 25-5582-2-2-5	Mirëmbajtja e programit financiar,menaxherial dhe administrativ dhe licencës softuerike për NPL Kastrioti Sh.A Obiliq	" Informatika Computers " Sh.p.k.	17,996.40 €	31.07.2028	Ne proces
20	NPL KASTRIOTI - 25-7151-1-4-7	Furnizim me material për depo të NPL Kastrioti Sh.A	MVR E SH.P.K.	734.00 €	05.09.2025	Perfunduar

21	NPL KASTRIOTI - 25-7247-1-4-7	Furnizim me perde për zyre të NPL Kastrioti Sh.A	Visar S. Fazliu B.I.	811.49 €	07.09.2025	Perfunduar
22	NPL KASTRIOTI - 25-7482-1-3-6	Furnizim me drita dhe paisjeve përcjllëse për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në tërë teritorin e Komunës së Obiliqit	ROA Group L.L.C.	5,391.50 €	18.02.2026	Perfunduar
23	NPL KASTRIOTI - 25-6760-1-2-1	Furnizim me mjete të ndryshme te punës (kosa,trimera)	N.P.T. "Bajra"	24,230.00 €	30.12.2026	Ne proces
24	NPL KASTRIOTI - 25-8574-1-4-7	Furnizim me thithëse elektrike për nevojat e NPL Kastrioti Sh.A	GETNO L.L.C.	974.00 €	18.10.2025	Perfunduar
25	NPL KASTRIOTI - 25-9078-1-4-7	Furnizim me kabllo për nevoja të NPL Kastrioti Sh.A	" Item EL " SH.P.K.	994.25 €	05.11.2025	Perfunduar
26	NPL KASTRIOTI - 25-9460-1-3-6	Furnizim me drita dhe paisjeve përcjllëse për mirëmbajtjen e ndriçimit publik në tërë teritorin e Komunës së Obiliqit sipas kontratës 04 24	" INFINITT " SH.P.K.	7,730.00 €	31.12.2025	Perfunduar
27	NPL KASTRIOTI - 25-9540-1-4-7	Furnizim me material elektrik për nevoja të Drejtoris së Arsimit KK Obiliq	ANESI SH.P.K.	978.75 €	19.11.2025	Perfunduar
28	NPL KASTRIOTI - 25-10934-1-3-6	Furnizim me materiale të ndryshme për dekorimin e qytetit të Obiliqit për festat e fundvitit 2025.	SELMANS NETWORK SH.P.K.	5,697.00 €	01.01.2026	Ne proces

29	NPL KASTRIOTI - 25-11205-1-3-6	Furnizim me materiale për rregullimin e ngrohjes në SHFMU "Ibrahim Rugova" në Obiliq dhe me kalda me lende djegse te ngurt (dru-thengjill)	Termo Solar Ingineering SH.P.K.	7,443.00 €	29.01.2026	Ne proces

TOTALI:	**237,183.44 €**

Procedurat e bartura në vitin 2026

Në fund të vitit 2025, një numër i procedurave të prokurimit kanë mbetur në zhvillim dhe do të vazhdojnë në vitin 2026. Këto procedura janë paraqitur në tabelën e mëposhtme, duke përfshirë të dhënat për numrin e prokurimit, përshkrimin, datën e inicimit dhe vlerën e parashikuar të kontratës.

Vlera e përgjithshme e këtyre procedurave në vijim është 127,094.00 €.

Nr. rendor i prokurimit	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e inicimit të procedurës	Vlera e parashikuar e kontrates
NPL KASTRIOTI - 25-11466-5-5-8	Furnizim me teknologji informative-kompjuter	22.12.2025	4,200.00 €
NPL KASTRIOTI - 25-11543-2-2-1	Marrja me qera e makinerive për nevoja të NPL Kastrioti SH.A	24.12.2025	20,000.00 €
NPL KASTRIOTI - 25-11600-1-2-1	Furnizim me materiale elektrike për nevoja të ndërmarrjes	30.12.2025	92,000.00 €
NPL KASTRIOTI - 25-11621-1-3-6	Furnizim me UNIFORMA	31.12.2025	9,990.00 €
NPL KASTRIOTI - 25-11623-1-4-7	Furnizim me material te ndryshme per nevoja te operatives NPL Kastrioti Sh.A	31.12.2025	904.00 €
		TOTALI:	**127,094.00 €**

16. RAPORTI FINANCIAR PËR VITIN FISKAL 2025

Ky raport financiar paraqet pasqyrën e përgjithshme të performancës financiare dhe pozitës financiare të ndërmarrjes për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025.

Raporti është përgatitur në përputhje me standardet dhe praktikat e aplikueshme të raportimit financiar, dhe përfshin analizën e të hyrave, shpenzimeve, rezultatin financiar, si dhe bilancin e gjendjes së ndërmarrjes.

Qëllimi i këtij raporti është të ofrojë një pasqyrë të saktë dhe të besueshme për menaxhmentin, bordin drejtues dhe palët e interesuara lidhur me aktivitetin financiar dhe performancën e ndërmarrjes gjatë periudhës raportuese.

Shënimet e të hyrave dhe shpenzimeve financiare për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2025:

Të hyrat nga shitja për vitin 2025

Gjatë vitit 2025, ndërmarrja ka realizuar të hyra nga shitja në bazë të kontratave të lidhura me drejtoritë e Komunës së Obiliqit, përfshirë: Drejtorinë e Arsimit, Drejtorinë e Shërbimeve Publike, Drejtorinë e Kulturës dhe Sportit, Drejtorinë e Administratës, Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Drejtorinë për Mbrojtje të Mjedisit.

Të hyrat janë paraqitur në mënyrë të strukturuar sipas kontratave përkatëse, duke u referuar vetëm në numrat e kontratave, ndërsa përshkrimi i detajuar i tyre është trajtuar në pjesën operative të raportit, me qëllim të shmangies së përsëritjes.

Përveç kontratave me institucionet publike, gjatë vitit raportues është realizuar edhe një e hyrë në vlerë prej 195.00 €, nga asgjësimi i materialeve, sipas evidencave përkatëse (subjekti: Mixhen Bucolli B.I.).

Totali i përgjithshëm i të hyrave nga shitja për vitin 2025 arrin në 625,132.51 €.
(Të gjithë vlerat janë prezantuar pa TVSH)

Kontratat	Drejtoria e Kulturës dhe Sportit
08/2023	9,505.27
02/2024	60,863.94
03/2024	35,689.41
04/2025	17,777.97
Totali:	**123,836.58**

Kontratat	Drejtoria e Shëndetësisë
08/2023	6,201.89
01/2024	6,873.80
02/2024	15,925.71
03/2024	8,538.98
Totali:	**37,540.38**

Kontratat	Drejtoria e Arsimit
08/2023	17,316.21
01/2024	17,161.52
02/2024	51,164.99
06/2024	23,162.03
01/2025	6,245.34
02/2025	13,478.14
Totali:	**128,528.23**

Kontratat	Drejtoria e Shërbimeve publike
08/2023	55,964.88
01/2024	2,005.00
03/2024	37,726.27
04/2024	73,919.05
Totali:	**169,615.20**

Kontratat	Drejtoria për Mbrojtje të Mjedisit
08/2023	144,948.83
Totali:	**144,948.83**

Kontratat	Drejtoria e Administratës
02/2024	20,468.28
Totali:	**20,468.28**

Kontratat	Mixhen Bucolli B.I.
Asgjesim	195.00
Totali:	**195.00**

Total të hyrat 2025: 625,132.51

Pasqyra e shpenzimeve për periudhën Janar – Dhjetor 2025

Shpenzimet gjatë vitit 2025, ndërmarrja ka realizuar shpenzime në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së saj operative dhe administrative. Struktura e shpenzimeve përfshin kostot e materialit shpenzues, shpenzimet për shërbime, shpenzimet komunale, shpenzimet e personelit, si dhe shpenzime të tjera përcjellëse.

Shpenzimet më të theksuara gjatë periudhës raportuese lidhen me kostot e materialit shpenzues operativ, shpenzimet e derivateve, shërbimet profesionale, si dhe shpenzimet e pagave dhe kontributeve pensionale, të cilat përbëjnë pjesën kryesore të kostos së përgjithshme.

Në tabelën e mëposhtme është paraqitur në mënyrë të detajuar struktura e shpenzimeve sipas kategorive përkatëse,
(Të gjithë vlerat janë prezantuar pa TVSH)

PASQYRA E TË ARDHURAVE	**31 Dhjetor 2025**
Të hyrat	
Të hyrat	625,132.46 €
Kostoja e mallit të shitur	39,552.05 €
Fitimi bruto	**585,580.40 €**
Shpenzimet	
Shpenzimet e pagave	578,797.85 €
Shpenzimet administrative	50,126.22 €
Shpenzimet e zhvlersimit	7,142.31 €
Shpenzimet të pazbritshme	97.65 €
Totali i shpenzimeve	**636,164.03 €**
Të ardhurat tjera	
Subvencioni	50,000.00 €
Super puna	1,400.00 €
Totali	**51,400.00 €**
Fitimi/ Humbja operative	**816.37 €**
Tatimi në fitim	91.40 €
Fitimi/Humbja Neto	**724.97 €**

Rezultati financiar për vitin 2025

Bazuar në pasqyrën e të ardhurave, ndërmarrja gjatë vitit 2025 ka realizuar një rezultat pozitiv financiar si rezultat i menaxhimit të të hyrave dhe kontrollit të shpenzimeve.

Pas përfshirjes së të gjitha të hyrave dhe shpenzimeve, si dhe pas llogaritjes së tatimit në fitim, ndërmarrja ka realizuar fitim neto në vlerë prej 724.97 €.

Ky rezultat pasqyron performancën financiare të ndërmarrjes gjatë periudhës raportuese.

Bilanci i Gjendjes për vitin 2025

Bilanci i gjendjes paraqet pozitën financiare të ndërmarrjes më datën 31.12.2025, duke reflektuar strukturën e mjeteve, detyrimeve dhe kapitalit.

Totali i aktiveve në fund të periudhës raportuese arrin në 269,426.54 €, dhe është në baraspeshë me totalin e detyrimeve dhe kapitalit.

Rezultati financiar i vitit 2025 është inkorporuar në kapital, duke ndikuar në rritjen e tij përmes përfshirjes në fitimet e pashpërndara, së bashku me rezultatet e akumuluara nga vitet paraprake.

	31 Dhjetor 2025 (në EUR)
PASURITË	
Pasuritë qarkulluese	
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	68,021.53
Llogaritë e arkëtueshme	124,826.74
Parapagimet	3,422.22
Stoqet	43,578.42
Totali i pasurive qarkulluese	**239,848.91**
Pasuritë jo-qarkulluese	
Prona, impiantet dhe paisjet	29,577.56
Totali i pasurive jo-qarkulluese	**29,577.56**
TOTALI I PASURIVE	**269,426.47**
EKUITETI AKSIONAR, REZERVAT DHE DETYRIMET	
Detyrimet afatshkurta	
Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera	11,974.57

Detyrimet tjera	150,804.35
Totali i detyrimeve afatshkurta	**162,778.92**
Ekuiteti Aksionar dhe Rezervat	
Kapitali aksionar	10,000.00
Fitimet/Humbjet e bartura	95,922.31
Fitimi apo Humbja e vititi financiar	724.97
Totali i Ekuitetit Aksionar dhe i Rezervave	**106,647.29**
TOTALI I EKUITETIT AKSIONAR, I REZERVAVE DHE I DETYRIMEVE	**269,426.21**

Bazuar në të dhënat e paraqitura në këtë raport, ndërmarrja gjatë vitit 2025 ka realizuar performancë pozitive financiare, duke arritur të gjenerojë fitim neto dhe të ruajë stabilitetin e saj financiar.

Menaxhimi i kujdesshëm i të hyrave dhe kontrolli i shpenzimeve kanë ndikuar në përmirësimin e rezultatit financiar dhe në forcimin e pozitës së kapitalit të ndërmarrjes.

Ndërmarrja mbetet e përkushtuar në vazhdimin e zhvillimit të qëndrueshëm, rritjen e efikasitetit operacional dhe përmbushjen e obligimeve ndaj të gjitha palëve të interesuara në periudhat e ardhshme.

17. DEKLARATË E MENAXHMENTIT

Menaxhmenti i ndërmarrjes është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2025, në përputhje me standardet dhe legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Menaxhmenti deklaron se pasqyrat financiare të paraqitura në këtë raport vjetor janë përgatitur mbi bazën e evidencave të sakta kontabël dhe se ato paraqesin në mënyrë të drejtë dhe të besueshme gjendjen financiare të ndërmarrjes, rezultatet e operimit dhe rrjedhat monetare për periudhën raportuese.

Gjithashtu, menaxhmenti konfirmon se janë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbajtjen e duhur të evidencave financiare, mbrojtjen e aseteve dhe parandalimin e gabimeve apo parregullsive materiale.

Të gjitha informacionet relevante për përgatitjen e këtij raporti janë paraqitur në mënyrë të plotë dhe të saktë.

18. PËRFUNDIMI

Ky raport vjetor për vitin 2025 përmbledh aktivitetet kryesore të NPL Kastrioti Sh.A. në të gjitha fushat operative, financiare, të prokurimit dhe administrates etj.

Përmes analizës së paraqitur në kapitujt përkatës, pasqyrohet puna e realizuar gjatë këtij viti dhe angazhimi i vazhdueshëm i stafit në përmbushjen e detyrave të përcaktuara.

Raporti mbyllet si dokument përmbledhës i aktiviteteve vjetore dhe shërben si bazë për planifikimin dhe përmirësimin e punës në vitin 2026.

Flakron Mjekiqi
U.D Kryeshef Ekzekutiv

Arbnore Kajtazi
Zyrtare Kryesore Financiare